

VENDIM
Nr.119, datë 7.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN NË GJUHËN SHQIPE DHE TË PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË NJËRËN NGA GJUHËT E BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Integrimit përkthen legjislacionin e Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe legjislacionin shqiptar në njëër nga gjuhët e BE-së. Për realizimin e kësaj veprimtarie, Ministria e Integrimit:

a) kryen përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njëër nga gjuhët e Bashkimit European;

b) rishikon përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, aktualisht të përkthyer nga ministritë e linjës apo institucione të tjera qendrore;

c) organizon procedurat e tenderimit, për realizimin e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të kuadrit normativ vendas në njëër nga gjuhët e BE-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik;

ç) krijon dhe përditëson bazën e të dhënave për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

d) kujdeset për respektimin e unitetit të formës dhe të terminologjisë së përkthimeve të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

dh) harton dhe boton dokumente e fjalorë të terminologjisë së specializuar, për përdorimin nga përkthyesit dhe nëpunësit civilë, të përfshirë në procesin e përkthimit të legjislacionit european në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

e) boton dhe shpërndan kopje të legjislacionit të Bashkimit European, të përkthyer në gjuhën shqipe.

2. Ministria e Integrimit, në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, përkatësisht sipas fushës së veprimtarisë së tyre, përcakton kalendarin vjetor të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njëër nga gjuhët e vendeve anëtare të BE-së.

3. Ministria e Integrimit përcakton përkthimin e akteve të veçanta normative vendase në njëër nga gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit European, të paparashikuara në kalendarin vjetor të përkthimit, vetëm kur akti i përkthyer kërkohet, në mënyrë specifike, nga strukturat përkatëse të Komisionit European, në zbatim të plotësimit të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Procesi i përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European kryhet nga subjekte të licencuara për kryerjen e kësaj veprimtarie, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

5. Miratimi i materialeve të përkthyer bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me propozimin e Ministrit të Integrimit.

6. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë: dy ekspertë të Ministrisë së Integrimit, një ekspert i ministrisë së linjës apo institucionit qendror, fusha e veprimtarisë e të cilit përputhet me fushën e veprimt të legjislacionit të Bashkimit European, që duhet të përkthehet, si dhe dy ekspertë të jashtëm të fushës, të caktuar nga Ministri i Integrimit.

7. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore janë të detyruara t’i vënë në dispozicion Ministrisë së Integrimit bazën e të dhënave të legjislacionit të Bashkimit European, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar, të përkthyer në njëër nga gjuhët e BE-së.

8. Përballimi i efekteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi, parashikohet në një zë të veçantë, në buxhetin vjetor, të miratuar për Ministrinë e Integrimit.

9. Ngarkohet Ministria e Integrimit të nxjerrë aktet nënligjore, për përcaktimin e kriterëve, të

rregullave dhe procedurave, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për kryerjen e kësaj veprimtarie, tarifat e shërbimit të përkthimit, organin përgjegjës për përcaktimin e këtyre çështjeve, si dhe për funksionimin e komisionit të posaçëm.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha